



01 Nr. 407/26 Dt. 04.09.2026



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i Adem Morinës-drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Prizrenit, bazuar në ftesën e Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon dhe në bashkëpunim me Rajonin e Kalabrisë, për pjesëmarrje në aktivitetet në komunat arbëreshe, që do të mbahen (zhvillohen) në Rajonin e Kalabrisë në Itali, nga data 18 shtator 2026 deri me 19 shtator 2026, kështu që, për këtë qëllim, lejohen mjetet e nevojshme financiare për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit, për pagesë të mëditjeve si dhe të shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurin.
2. Nisja (shkuarja) zyrtare bëhet me datë 18 shtator 2026, ndërsa kthimi me 20 shtator 2026.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës-pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.
4. Obligohet i lartcekuri, Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Të lartcekurit,
 - Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik
 - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Arkivës së Kryetarit.